

Kushtetuta e garanton të drejtën tuaj për mbrojtje të të dhënave personale. Ajo parasheh që mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale rregullohet me ligj.

E drejta për mbrojtje të të dhënave personale është e drejtë e juaja kushtetuese

Cila është baza ligjore për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale?

Obligimet, përgjegjësitë dhe masat për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale janë paraparë në Ligjin nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale (mund të qaset në: <https://gzk.rks-gov.net>)

Çka janë “të dhënat personale”?

Të dhënat personale janë çdo informacion përmes së cilit mund të identifikohet një person fizik p.sh. subjekt i të dhënave (emri, numri i letërnjoftimit, adresa e shtëpisë, informata nga dëftesa e pagës etj.)

Çka janë të dhënat personale të ndjeshme?

Çdo e dhënë personale që zbulon:

- Origjinën racore apo etnike;
- Mendimet politike apo filozofike;
- Besimet fetare;
- Anëtarësia në sindikatë;
- Informacioni për gjendjen shëndetësore
- Informacioni për jetën seksuale.
- Informacioni për historinë e veprave penale dhe kundërvajtëse.

Tiparet biometrike si p.sh. shenjat e gishtërinjve, shenjat papilare të gishtërinjve, iridës, retinës, karakteristikat fytyrore dhe ADN-ja gjithashtu konsiderohen të dhëna personale të ndjeshme.

Të dhënat personale të ndjeshme gëzojnë mbrojtje më të madhe p.sh. përpunimi i atyre të dhënave kërkon plotësim të kriteve më strikte.

Kush është kontrolluesi dhe kush përpunuesi i të dhënave?

Kontrolluesi i të dhënave është personi juridik, nga sektori publik apo privat që e përcakton qëllimin e shfrytëzimit të të dhënave personale.

Përpunuesi i të dhënave është fizik a juridik, nga sektori publik apo privat që i përpunon të dhënat personale, në emër të dhe me udhëzime të kontrolluesit të të dhënave.

Përgjegjësia përfundimtare për përpunim të të dhënave bie mbi kontrolluesin e të dhënave.

Çka është përpunimi i të dhënave?

Përpunimi i të dhënave është çdo veprim që bëhet me të dhënat personale, p.sh. mbledhja, regjistrimi ruajtja, përshtatja, ndryshimi, përdorimi, zbulimi, shpërndarja etj.

Parimet e përpunimit të të dhënave

Sipas ligjit, të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe ligjshme pa e shkelur dinjitetin e subjekteve të të dhënave.

Përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm në rend të parë nëse subjekti i të dhënave e jep pëlqimin për këtë.

Mirëpo, të dhënat personale mund të përpunohen, nëse është e nevojshme, pa pëlqimin e subjektit për:

- përmbushje të kontratës;
- përmbushje të obligimit ligjor të kontrolluesit të të dhënave apo për interesin e tij legjitim;
- mbrojtje të interesave vitale të personit;
- për përmbushjen e një detyre të organit publik;
- për interesa legjitim që kërkohet të arrihen nga kontrolluesi apo pala e tretë; përveç kur këto mbizotërohen nga të drejtat dhe liritë themelore të subjektit.

Përpunimi i të dhënave të ndjeshme lejohet për qëllime më të kufizuara (p.sh. përmbushje të obligimeve kontraktuese në fushën e punësimit, për shërbime shëndetësore, për mbrojtjen e interesit qenësor publik etj.) në kushte edhe më strikte.



Kujdes! Nëse të dhënat tuaja të ndjeshme i bëni publike (p.sh. në facebook) ato të dhëna mund të shfrytëzohen nga tjerët.

Raste tjera të përpunimit të të dhënave dhe vendimmarrjes së automatizuar

Vendimmarrja e automatizuar është përpunimi që përdor mjetet e teknologjisë informative për t'i vlerësuar disa aspekte të caktuara personale (p.sh. vlerësimi i vlerës së kredisë, aftësive që kanë të bëjnë me punën, besueshmërinë etj.). Vendimmarrja e automatizuar është e ligjshme nëse subjekti i të dhënave ka mundësi për ta kundërshtuar atë vendim apo për ta shpreh mendimin e tij.

E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale

sign informaciona të ndjeshme personale a të ndjeshme